

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[28.01.2022]

Drejtuar: [FEDOS , Njësia Administrative nr. 2, Rruga “Manol Konomi”, Ndërtesa nr. 14, Hyrja 2, Apartamenti 2, Tiranë, 1017]

Procedura e prokurimit/lotit: E Hapur e Thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-15329-12-15-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje tuba dhe materiale konsumi për marrjen e kampioneve të gjakut për laboratorin klinik biokimik për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” ndarë në lote, gjithsej 2 (dy) Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)**

Loti I: Blerje tuba per marrjen e kampioneve të gjakut për laboratorin klinik biokimik

Nr	Emertimi	Volumi, permasat	Specifikime Teknike	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1	Tub me Trisodium Citrate Plasma (0.109M,3.2%) per teste koagulimi. Sistem i mbyllur hemogard me vakum. Tape Bojeqielli	1.8-2.7 ml, 13X75mm		25000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
2	Tuba me xhel per serum me aktivator koagulimi silica me kohe koagulimi jo me te madhe se 30 minuta. Sistem I mbyllur hemogard me vakum. Tape e Verdhe	3.5ml, 13x75mm - 5 ml, 13X100mm	Ndaresi xhel	20000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
3	Tuba me Litium Heparin per plazem, Sistem i mbyllur hemogard me vakum. Tapa Jeshile	2-4 ml, 13X75mm		400	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
4	Tuba me K3 EDTA, Sistem I mbyllur	2-4 ml,			Spitali Rajonal	Brenda afatit të MK, sipas

	hemogard me vakum. Tape lejla	13X75mm		40000	Vlorë	nevojave të AK
5	Tub me Natrium Citrat per matjen e eritrosedimentacionit (ESR), Tape e zeze	1,6 - 5 ml	Te shoqerohet me stativ me mbajtjes/mates ose me aparat mates ESR me kapacitet jo me pak se 60 teste ne ore.	10000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
6	Tub me K2/K3EDTA per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike	Volum 250- 500 µl (0.25- 0.5 ml)		7500	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
7	Tub me xhel per serum per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike	Volum 400- 1000 µl (0.4-1 ml)		7500	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
8	Set Age per marrje gjaku, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.	21 G, gjatesia e gjilperes 19 mm, gjatesia e tubit jo me e vogel se 17 cm	Rekomandohe n sistemet e ages me kapuc per te shmangur kontaminimin ose me buton terheqes se ages per mbrojtje e personelit nga shpimi aksidental	5000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
9	Shiringe per marrje gjaku me litium heparine	1-3ml, 21-22G	E pershtatshme per gazet ne gjak	3000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
10	Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave	21-22G		1000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK

11	Zhgute (llastik) per shtrengimin e e krahut ku do merret gjaku			80	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
12	Adaptor per tubat e gjakut, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.			5000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK
13	Age flutur per marrjen e gjakut	e pajisur me valvol		100000	Spitali Rajonal Vlorë	Brenda afatit të MK, sipas nevojave të AK

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1.GAMMA

K31510153H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 3 500 000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. ALMedical

K21511002I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 5 190 500 (pesë milion e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. FEDOS

K01514009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 8 897 000 (tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

4. KRIJON

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera ska dorëzuar ofertë ekonomike

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1 GAMMA

K31510153H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

1- Oferte Anomalisht e Ulet, KVO sqaron:

Në përgjigje të shkreses suaj, të dërguar të protokolluar pranë Sekretarisë me nr 376 prot date 26.01.2022 me lëndë: Argumentim Oferte, në mbështetje të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Neni 93 Oferta Anomalisht e Ulët: "1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë." sqarojmë:

Së pari, pretendoni se keni argumentuar cmimet/kostot e propozuara në ofertë duke sjellë si dokument justifikues:

1- Faturën me numër 56 të datës 17/01/2022 për artikullin me nr. 1 të DST :

1	Tub me Trisodium Citrate Plasma (0.109M,3.2%) per teste koagulimi. Sistem i mbyllur hemogardme vakum. Tape Bojeqielli
---	--

2-Ofertë të Vacutest Kima srl të datës 17.01.2022 ku ofertohen cmimet për artikujt si më poshtë:

2	Tuba me xhel per serum me aktivator koagulimi silica me kohekoagulimi jo me te madhe se 30 minuta. Sistem I mbyllur hemogard me vakum. Tape e Verdhe
3	Tuba me Litium Heparin per plazem, Sistem i mbyllur hemogard me vakum. Tapa Jeshile
4	Tuba me K3 EDTA, Sistem I mbyllur hemogard me vakum. Tape lejla
5	Tub me Natrium Citrat per matjen e eritrosedimentacionit (ESR), Tape e zeze
6	Tub me K2/K3EDTA per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike
7	Tub me xhel per serum per marrjen e gjakutkapilar per moshatpediatrike
8	Set Age per marrje gjaku, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.
12	Adaptor per tubat e gjakut, te pershtatshme per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar.

3-Listën e cmimeve neto të eksportit të APTACA SPA për artikujt:

10	Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave
11	Zhgute (llastik) per shtrengimin e e krahut ku do merret gjaku
13	Age flutur per marrjen e gjakut

4-Lista ndërkombëtare e cmimeve të distributorit Labor Diagnostik Systems për artikullin:

9	Shiringe per marrje gjaku me litium heparine
---	--

Mbas verifikimit të dokumentacionit të sipërcituar, ju bëjmë me dije se **i vetmi material i besueshëm i paraqitur prej jush është fatura për artikullin e parë e cila garanton që malli është i siguruar nga kompania juaj**, ndërkohë oferta e paraqitur për tetë prej artikujve të tjerë në materialin nr 2, në këndveshtrimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **nuk trajtohet si material i besueshëm**, pasi një ofertë e vetme nuk garanton dhe **nuk siguron vlerat reale të tregut**, e sqaruar kjo në kontekstin që oferta nuk jep siguri, sic do të ishte në të kundërt një kontratë furnizimi në vazhdimësi për këto artikuj apo faturë blerjeje si në rastin e artikullit të parë. Ofertat janë dokument financiar jo i besueshem juridikisht sikurse është kontrata apo marrëveshjet juridike midis palëve që japin garancinë e sigurimit të mallit.

Si rrjedhim, **kompania nuk juaj nuk bind komisionin e vlerësimit të ofertave** se ju do të furnizoheni me këto cmime për artikujt me nr. 2,3,4,5,6,7,8 dhe 12., pasi ofertat mund të ndryshojnë me ndryshimin e kushteve apo faktorëve që lidhen drejtpërsëdrejti me të dhe në kohën e pandemisë kjo është akoma më e ndodhshme.

Për sa i përket, materialit nr. 3 që sipas jush, është lista e cmimeve neto të eksportit për artikujt që pretendoni se furnizoheni nga APTACA SPA, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, u përpoq ta verifikonte këtë material në faqen zyrtare të web-it të kompanisë APTACA (<http://www.aptaca.com>), por pa rezultat.

Duke qenë një material i **papublikuar, pa firmë apo vulë zyrtare** të kompanisë, elementë juridik që sigurojnë autencitet edhe vlefshmërinë / origjinalitetin e kësaj liste.

Për më tepër, në këtë listë janë evidentuar prej jush tre prej artikujve, artikulli 10,11 dhe 13, për të cilët gjejmë me vend t'ju përmendim se gjatë shqyrtimit të ofertës suaj në Sistemin e Prokurimeve Publike, në deklaratën e origjinës së mallit që mban datën 21.01.2022,

- ju deklaroni se për artikullin 13, Kompania Prodhuese është **Reis**,

- ndërkohë keni ofertuar me **cmimin e këtij artikulli** në atë që ju pretendoni se është lista e cmimeve të produkteve të ofruara nga kompania **APTACA SPA**,

- ndersa në mostrat e dorëzuara ky artikull në ambalazhimin tuaj mban nr. 13, kodin 3141 emrin e kompanisë **APTACA SPA**, **ndërsa në ambalazhimin e vetë produktit, mban emrin e Rays srl.**

Komisioni është i paqartë nëse ju furnizoheni nga Reis, Rays srl, apo APTACA, dhe si i tillë cmimi për këtë artikull është i pajustificuar nga ana juaj.

Përsa i përket materialit nr 4, në të njëjtën logjikë nga sa arsyetuam edhe më sipër për listen e cmimeve te produkteve te APTACA, as ky material nuk trajtohet i besueshëm nga ana e KVO.

Së dyti, në materialin ku ju argumentoni ofertën tuaj, shpreheni si mëposhtë vijon:

“per cdo import, marzhet e shtuara shkojne nga 0%-3% (kosto transporti, procedura zhdoganimi, dhe kosto te tjera shtese deri ne magazinim), por nuk keni sjellë dokumenta justifikues për këto që ju i quani kosto, aq më tepër ju vëmë në dukje se kostot tuaja nuk mbarojnë deri në magazinimin e produktit, sepse në atë që ofertoni duhet të përfshini dhe kostot e tjera shtesë deri në dërgesën e mallit në vendndodhjen e Spitalit Rajonal Vlorë, kosto të tilla minimalisht mund t’ju përmendim: kosto karburanti dhe kosto të automjetit që do të bejë transportin e mallit (paga e shoferit , siguracionet dhe taxat e automjetit, kosto mirëmbajtje automjeti, etj.)

Si rrjedhim, Komisioni i vlerësimit të ofertave vazhdon të jetë i paqartë se sa janë realisht kostot shtesë për produktet që ju ofroni deri në destinacionin tonë.

Së treti, përveç shpjegimeve që ju detyroheni të jepni për Ofertën Anomalisht të Ulët në bazë të Nenit 93 Oferta anomalisht e ulët, **për cmimin dhe kostot**, të cilat rezultojnë të pa plota dhe të paargumentuara në bazë të dokumentave me vlerë ligjore që ju keni paraqitur, ju bëjmë me dijeni se ju nuk keni sjellë **asnjë material justifikues** në lidhje me pikën ç të nenit të sipërcituar : “ç) *pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;*”

KVO është e paqartë se sa janë shpenzimet e kompanisë suaj për detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, shpenzimet për energji elektrike, listëpagesat e punonjësve, detyrimet ndaj tatimeve, detyrimet për taksat vendore, etj.

Së fundmi, që të bëni kostifikimin e ciklit jetësor te produktit që ju ofroni, ju rikujtojmë Nenin 88 të Ligjit te Prokurimit Publik ne fuqi : Neni 88 **Llogaritja e koston gjatë ciklit jetësor** “1. *Llogaritja e koston gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:*

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim”

ku në bazë të këtij neni, materialet e sjella prej jush kanë të bëjnë vetëm me koston që lidhen me **blerjen e produktit**, kosto të cilat përveç artikullit me nr.1, **mbeten të paargumentuara në këndvështimin e KVO**, ndërsa për koston e përdorimit, të mirëmbajtjes apo kostot në fund të kohës së përdorimit si janë kostot për grumbullim në rastin e kompanisë tuaj, KVO nuk disponon asnjë material justifikues që të verifikojë vlerën reale të tyre.

Si rrjedhim, oferta juaj refuzohet pasi pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ju, KVO nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të Nenit 93 të LPP Oferta anomalisht e ulët.

2-Në vlerësimin e mostrave KVO sqaron:

Mostra : Artikulli nr. 9 “ Shiringe per marrje gjaku me litium heparine “nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST.

Nuk ploteson piken 2.3.8 te te kriterëve te vecanta ne lidhje me paraqitjen e kataloge teknike dhe konkretisht katalogun e firmes Rays s.p.a e cila eshte deklaruar si firma prodhuese e artikullit 13 “ age flutur per marrjen e gjakut .

Nuk ploteson piken 2.3.9 te kriterëve te vecanta ne lidhje me mostrat e paraqitura nga ky OE dhe konkretisht:

Mostra : Artikulli nr.9 “ Shiringe per marrje gjaku me litium heparine “nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST.

Kemi mosperputhje midis mostres dhe katalogut : shiringa ka ne ambalazhin e saj emertimin e firmes prodhuese si ne katalog SC Sanguins kurse ne ambalazhin e gjilperes eshte emertimi i firmes Rays spa me nr.kodi te ndryshem qe nuk e gjejme ne katalog

Mostra : Artikulli nr.10 “ Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjat “nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST sepse mostra nuk eshte artikulli i kerkuar nga AK ne DST ,ajo eshte nje gjilpere shpuese e zakonshme dhe lancet (gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjat)

Mostra “ Artikulli nr.13 “Age flutur per marrjen e gjakut “nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST .Mostra eshte e firmes prodhuese RAYS s.p.a e me kod SVS21G e cila eshte firma prodhuese e deklaruar ne deklaraten e origjines se mallit por kodi dhe ambalazhi eshte i firmes APTACA .

2. ALMedical

K21511002I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme:

Në vlerësimin e mostrave KVO sqaron:

Nuk ploteson piken 2.3.9 te kriterëve te vecanta ne lidhje me mostrat e paraqitura nga ky OE dhe konkretisht,

Mostra :Artikulli nr.7 “ Tub me xhel per serum per marrjen e gjakut kapilar per moshat pediatrike” nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST konkretisht

1-volumi i tubit kerkohe 0.5 ml kurse volumi i mostres eshte 5 ml

2- kodi ne moster eshte 235305 kurse kodi ne katalog eshte 238305

Mostra : Artikulli Nr.12 “Adaptor per tubate gjakut ,te pershtatshem per te gjithë tubat e sistemit me vakum te ofruar “ nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST konkretisht: Oe ka paraqitur mbajtese te te gjilperes per grumbullimin e gjakut dhe jo adaptor (kapuc) per mbajtjen e tubave

Mostra “ Artikulli nr.13 “Age flutur per marrjen e gjakut “nuk eshte ne perputhje me specifikimet teknike te paraqitur ne DST konkretisht: Mostra e paraqitur eshte kanjul ose ndryshe vigon dhe jo age flutur per marrjen e gjakut .

3. KRIJON

K12023001A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme:

Mungesë dokumentacioni.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [FEDOS , Njësia Administrative nr. 2, Rruga “Manol Konomi”, Ndërtesa nr. 14, Hyrja 2, Apartamenti 2, Tiranë, 1017], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8 897 000 (tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH] / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.

[Brunilda Mersini]